

15,315,896€

janë të hyrat e kompanive të sigurimit nga shitja e policave të brendshme TPL gjatë periudhës janar-mars 2023.

iSIGURIMET

Nr. #043-044 • Maj-Qershor 2023 • www.bks-ks.com

20 milionë euro
dëme u paguan vetëm
për 3 muaj

04



DYSHIME PËR INSKENIM
AKSIDENTESH, NJË PERSON
I PËRFSHIRË NË 29 AKSIDENTE
BRENDA DY VITEVE

08

SIGURIMET VULLNETARE U RRRITËN PËR

23,23%



Rritet për 74 % shitja e policave për sigurimin e sëmundjeve

Gjatë tre muajve të parë të këtij viti, respektivisht janar, shkurt dhe mars, shitja e policave për sigurimin e sëmundjeve është rritur për 74 % në

raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Duke iu referuar të dhënave zyrtare shihet se gjatë muajve janar, shkurt dhe mars të këtij viti janë

shitur 97,215 polica për sigurimin e sëmundjeve, derisa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak janë shitur 55,848 të tilla, ku shihet një rritje prej 74 %.



99,587 polica TPL u shitën për dy muaj

Sipas të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës shihet se vetëm gjatë muajve janar, shkurt dhe mars të këtij viti, kompanitë e sigurimeve në Kosovë kanë shitur

99,587 polica TPL e brendshme, e nëse e bëjmë një krahasim me periudhën e njëjte të vitit paraprak shihet se shitja e policave gjatë kësaj periudhe është më e lartë

për 9,15 % në raport me muajt janar, shkurt dhe mars 2022, ku sipas të dhënave zyrtare në ata muaj janë shitur 91 mijë e 238 polica TPL e brendshme.



16,42 % është rritur shitja e policave TPL Plus

Gjithnjë duke iu referuar të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës shihet se gjatë muajve janar, shkurt dhe mars të këtij viti kompanitë e sigurimeve

në vend kanë arritur të shesin 22,884 polica TPL Plus, nga 19,656 sa i kishin shitur gjatë periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Nëse bëjmë një përlllogaritje

shihet se shitja e policave TPL Plus gjatë kësaj periudhe është rritur për 16,42 % më shumë në raport me muajt janar, shkurt dhe mars të vitit që lamë pas.



20 MILIONË EURO DËME U PAGUAN VETËM PËR 3 MUAJ

Gjatë muajve janar, shkurt dhe mars të 2023 kompanitë e sigurimeve të licencuara nga Banka Qendrore, si dhe Byroja Kosovare e Sigurimit kanë arritur të paguajnë hiç më pak se 20 milionë euro për kompensim të dëmeve, apo 35 % më shumë se sa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Si asnjëherë më parë pagesa e dëmeve si nga kompanitë, ashtu edhe nga BKS-ja po kryhen në afate kohore rekorde.

Sikurse në muajt paraprak edhe gjatë muajve janar, shkurt e mars të këtij viti industria e sigurimeve ka vazhduar me trend të njëjtë të pagesës së dëmeve për palë të dëmtuara. Si kurrë më parë vetëm gjatë tre muajve të parë të vitit kompanitë e sigurimeve, si dhe Byroja Kosovare e Sigurimit paguan hiç më pak se 20 milionë euro për kompensim të dëmeve nga palët e dëmtuara si në aksidente komunikacioni, ashtu edhe trajtim të sëmundjeve të ndryshme të cilat i mbulon polica. Sipas të dhëna zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), shihet se muajt janar, shkurt dhe mars të këtij viti kanë qenë rekord i pagesës së mjeteve për kompensim të dëmeve. Vetëm gjatë muajve janar dhe shkurt 2023 kompanitë e sigurimeve të licencuara nga Banka Qendrore si dhe Byroja Kosovare e Sigurimit kanë arritur të paguajnë hiç më pak se 20 milionë euro për kompensim të dëmeve, apo 35 % më shumë se sa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Rritje shumë e lartë e pagesës së dëmeve

Gjithnjë duke iu referuar të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës shihet se 48,165 dëme janë paguar nga kompanitë e sigurimeve si dhe BKS-ja vetëm gjatë muajve janar, shkurt dhe mars 2023. Nëse bëjmë një krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak shihet qartë se pagesa e dëmeve është rritur prej hiç më pak se 35%. “Numri i dëmeve të paguara gjatë periudhës janar-mars 2023 në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak është rritur për 5,814 dëme, duke arritur në 48,165, nga

të cilat 48,064 dëme janë paguar nga kompanitë e sigurimit të Jo-Jetës dhe 101 nga kompanitë e sigurimit të Jetës”, thuhet në raportin e fundit të Bankës Qendrore të Kosovës, sa i përket periudhës janar-shkurt të këtij viti.

Dëmet e paguara në pesë vitet e fundit

Duke iu referuar të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) shihet se gati gjysma e të hyrave totale të kompanive të sigurimeve dhe Byrosë Kosovare të Sigurimeve gjatë 5 viteve të fundit është shpenzuar për kompensim të dëmeve. Bazuar në të dhëna zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës shihet se gjatë kësaj periudhe kohore vlera e primeve të shkuara ka qenë 539 milionë euro, derisa vlera e dëmeve të paguara 260 milionë euro. Në vitin 2018 sipas të dhënave të BQK-së shihet se vlera e Primeve të shkruara bruto ka qenë 92.1 milionë euro, derisa vlera e dëmeve të paguara nga kompanitë e sigurimeve dhe BKS-ja ka qenë 42,9 milionë euro. Bazuar në këto të dhëna del se 46 % e të hyrave totale gjatë vitit 2018 janë shpenzuar vetëm për kompensim të dëmeve. Po ashtu, edhe gjatë vitit 2019 të hyrat totale të kompanive të sigurimeve nga Primet e shkruara Bruto kanë arritur në 99,2 milionë euro, derisa gjatë këtij viti në emër të dëmeve kompanitë e sigurimeve, por edhe Byroja Kosovare e Sigurimeve kanë paguar hiç më pak se 47,9 milionë euro. Gjatë këtij viti shihet se mbi 48 % e të hyrave totale të kompanive janë shpenzuar për kompensim të dëmeve për palë të dëmtuara.

35%

është rritur pagesa e dëmeve gjatë muajit janar-mars 2023 në raport me muajin janar-mars 2022

48,165

dëme janë paguar nga kompanitë e sigurimeve si dhe BKS-ja vetëm gjatë muajit janar - marst 2023

5,814

është më i lartë numri i dëmeve të paguar gjatë muajit janar - mars 2023 në raport me periudhën e njëjtë 2022

19,854,148 €

dëme janë paguar nga kompanitë e sigurimeve si dhe Byroja Kosovare e Sigurimit vetëm gjatë muajit janar - mars 2023



SIGURIMET VULLNETARE U RRRITËN PËR 23,23 %

Tregu i sigurimeve vullnetare gjatë vitit 2022 në raport me vitin paraprak është rritur për 23,23 %. Sipas të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës shihet se gjatë vitit 2022 vlera e primeve të shkruara bruto sa i përket sigurimeve vullnetare arriti në 52,5 milionë euro, nga 42,6 milionë sa ishin në vitin paraprak, pra 2021.

Gjatë vitit që lamë pas tregu i sigurimeve vullnetare në vendin tonë është rritur si asnjëherë më parë. Bazuar në të dhënat zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) shihet se gjatë vitit 2022 vlera e primeve të shkruara bruto sa i përket sigurimeve vullnetare arriti në 52,5 milionë euro, nga 42,6 milionë sa ishin në vitin paraprak, pra 2021. Tregu i sigurimeve gjatë vitit 2022 në raport me vitin paraprak është rritur për 23,23 %. Drejtori i Byrosë Kosovare të Sigurimit, Sami Mazreku, thotë se zhvillimi i tregut të sigurimeve vullnetare tregon për zhvillimin dhe modernizimin e sektorit të sigurimeve në vendin tonë. Sipas tij, sektori i sigurimeve në vendin tonë është duke u zhvilluar nga dita në ditë. “Duke nisur nga pronaret e kompanive, por edhe nga drejtoret e kompanive është punuar shumë për ta sjellë sektorin e sigurimeve në këtë gjendje siç është tash. E them me përgjegjësi së sektori i sigurimeve në Kosovës është i njëjtë sikurse në shtete të zhvilluara. Dëmet trajtohet me kohë dhe paguhet me kohë”, ka thënë drejtori Mazreku.

TREGU I SIGURIMEVE VULLNETARE DHE OBLIGATIVE

Gjithnjë duke iu referuar të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës shihet se në vitin 2022 vlera e primeve të shkruara bruto sa i përket sigurimeve obligative TPL arriti në 68,8 milionë euro, derisa ato vullnetare arritën në 52,5 milionë euro. Në këto vlera nuk përfshihet fare të hyrat nga sigurimi vullnetare. Në vitin 2021 vlera e primeve të shkruara bruto sa i përket sigurimeve obligative ishte 64,5 milionë euro, derisa vlera e primeve të shkruara bruto sa i përket sigurimeve vullnetare ishte 42,6 milionë euro. Po ashtu, edhe në vitin 2021 nëse u referohemi të dhënave të BQK-së shihet se vlera e primeve të shkruara bruto sa u përket sigurimeve obligative ishte 57,6 milionë euro, nga 36,3 milionë euro sa ishin ato vullnetare. Sipas të dhënave zyrtare të BQK-së shihet se në vitin 2019 vlera e primeve të shkruara bruto sa i përket sigurimeve obligative ishte 51,2 milionë euro, derisa vlera e primeve të shkruara bruto sa i përket sigurimeve vullnetare ishte 39 milionë euro.

NË VITIN 2018 TREGU I SIGURIMEVE VULLNETARE ISHTE 34,4 MILIONË EURO

Në vitin 2018 sipas të dhënave zyrtare shihet se vlera e primeve të shkruara bruto sa i përket sigurimeve obligative ishte 48,6 milionë euro, derisa vlera e primeve të shkruara bruto sa i përket sigurimeve vullnetare ishte 34,4 milionë euro. Po ashtu, edhe në vitin 2017, duke iu referuar të dhënave zyrtare të BQK-së shihet se të hyrat nga sigurimet obligative ishin 47,6 milionë euro, derisa të hyrat nga sigurimet vullnetare ishin 30,2 milionë euro. Edhe në vitin 2016 sipas të dhënave zyrtare shihet se vlera e primeve të shkruara bruto sa i përket sigurimeve obligative ishte 45,8 milionë euro, derisa të hyrat nga primet e shkruara bruto sa u përket sigurimeve vullnetare ishte 28,8 milionë euro. Gjithnjë duke iu referuar të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës shihet se në vitin 2015 të hyrat nga tregu i sigurimeve obligative ishin 43,1 milionë. Në vitin 2014 sipas të dhënave zyrtare shihet se të hyrat nga tregu i sigurimeve obligative ishte 42,3 milionë euro, derisa të



hyrat nga tregu i sigurimeve vullnetare ishin 23,2 milionë euro.

NË VITIN 2003, TË HYRAT NGA SIGURIMET VULLNETARE ISHIN 1,3 MILIONË EURO

Në vitin 2013 sipas të dhënave zyrtare shihet se të hyrat nga sigurimet obligative kanë qenë 43,9 milionë euro, derisa të hyrat nga sigurimet vullnetare kanë qenë 20,4 milionë euro. Po ashtu, edhe në vitin 2012 të hyrat nga sigurimet obligative kanë qenë 44,2 milionë euro, derisa të hyrat nga sigurimet vullnetare kanë qenë 22,6 milionë euro. Gjithashtu në vitin 2011, referuar të dhënave zyrtare të BQK-së, shihet se të hyrat nga sigurimet obligative kanë qenë 45,8 milionë euro, derisa ato vullnetare 22,7 milionë euro. Në vitin 2010 të hyrat nga sigurimet obligative kanë qenë 40,6 milionë euro, derisa atyre vullnetare prej 20 milionë euro. Në vitin 2009 sipas të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës shihet se të hyrat nga sigurimet obligative kanë qenë 36,4 milionë euro, derisa ato vullnetare 18,7 milionë euro. Gjithashtu edhe në vitin 2008 të hyrat nga sigurimet obligative ishin prej 35,6 milionë euro, derisa ato vullnetare prej 9,9 milionë euro. Edhe në vitin 2007 të hyrat nga shitja e policave obligative ishin 34,9 milionë euro, derisa ato vullnetare ishin prej 5,7 milionë euro. Sipas të dhënave zyrtare shihet se në vitin 2006 të hyrat nga shitja e policave obligative ishte 34,7 milionë euro, derisa ato vullnetare 4,6 milionë euro. Duke iu referuar të dhënave të BQK-së shihet se në vitin 2005 të hyrat nga primi bruto i policave obligative ishin 33,3 milionë euro, derisa atyre vullnetare 6,8 milionë euro. Në vitin 2004 të hyrat nga shitja e policave obligative, pra TPL ishin 28,2 milionë euro, derisa atyre vullnetare 1,7 milionë euro, si dhe në fund në vitin 2003 të hyrat nga shitja e policave obligative ishin 29,2 milionë euro, derisa ato vullnetare 1,3 milionë euro.

Viti	TPL	Vullnetare
2022	68,8 milionë €	52,5 milionë €
2021	64,5 milionë €	42,6 milionë €
2020	57,6 milionë €	36,3 milionë €
2019	51,2 milionë €	39,0 milionë €
2018	48,6 milionë €	34,4 milionë €
2017	47,6 milionë €	30,2 milionë €
2016	45,8 milionë €	28,8 milionë €
2015	43,1 milionë €	25,5 milionë €
2014	42,3 milionë €	23,2 milionë €
2013	43,9 milionë €	20,4 milionë €
2012	44,2 milionë €	22,6 milionë €
2011	45,8 milionë €	22,7 milionë €
2010	40,6 milionë €	20,0 milionë €
2009	36,4 milionë €	18,7 milionë €
2008	35,6 milionë €	9,9 milionë €
2007	34,9 milionë €	5,7 milionë €
2006	34,7 milionë €	4,6 milionë €
2005	33,3 milionë €	6,8 milionë €
2004	28,7 milionë €	1,7 milionë €
2003	29,2 milionë €	1,3 milionë €

BQK: ASETET E SEKTORIT TË SIGURIMEVE U RRI TËN PËR 11,2 %

Në raportin e vlerësimit tremujor të Ekonomisë së Bankës Qendrore të Kosovës thuhet se sektori i sigurimeve shënoi rritje të aktivitetit për të katërtin vit me radhë përkundër zhvillime jo të favorshme politike, ekonomike dhe financiare që mbizotëruan gjatë vitit 2022

Sektori i sigurimeve shënoi rritje të aktivitetit për të katërtin vit me radhë; përkundër zhvillime jo të favorshme politike, ekonomike dhe financiare që mbizotëruan gjatë vitit 2022. Asetet e sektorit të sigurimeve përfaqësuan 2.7 përqind të gjithëj aseteve të sistemit financiar në fund të vitit 2022. Vlera e gjithëj aseteve në fund të periudhës arriti në 267.5 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 11.2 përqind, duke vazhduar trendin e rritjes dyshifrore në vitet e fundit. Sipas raportit të Bankës Qendrore të Kosovës, zgjerimi i sektorit kryesisht erdhi si rezultat i rritjes së rezervave teknike, që burojnë nga primet e shkruara, si dhe kapitalit vetanak (kapitalit aksionar dhe fitimit të realizuar).

Në kuadër të aseteve, rritjen më të theksuar shënoi kategoria e depozitave të mbajtura në bankat komerciale, që janë kryesisht në formë të depozitave të afatizuara. Kategoria e dytë për nga pesha, ajo e Letrave me Vlerë

të Qeverisë së Kosovës, shënoi rritje, por më të ngadalësuar krahasuar me një vit më parë, si rezultat i nivelit më të ulët të borxhit të emetuar nga Qeveria e Kosovës vlera e primeve të shkruara në vitin 2022 arriti në 134.0 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 14.1 përqind.

Rritja e primeve të shkruara reflekton kryesisht rritjen e primeve të shkruara të kategorisë 'aksidenti dhe shëndeti', në kuadër të sigurimit vullnetar. Kurse, primet e shkruara ndaj sigurimit të detyrueshëm vazhdojnë të kenë peshën më të madhe, prej 58.9 përqind të gjithëj primeve të shkruara jo-jetë. Rritja e primeve në kuadër të sigurimit 'aksidenti dhe shëndeti' (për 29.3 përqind) është sinjal pozitiv për rritje të numrit të qytetarëve që posedojnë sigurimi shëndetësor.

Përderisa, rritja e primeve të sigurimit të detyrueshëm reflekton kryesisht kategorinë e 'sigurimit të detyrueshëm të Autopërgjegjësisë

- MTPL', që shënuan rritje për 5.4 përqind. Në anën tjetër, vlera e dëmeve të paguara nga kompanitë e sigurimit dhe Byroja Kosovare e Sigurimeve në vitin 2022 arriti vlerën prej 64.3 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 5.4 përqind (24.4 përqind një vit më parë). Vlera e dëmeve të paguara nga BKS-ja ka shënuar rënie prej 13.3 përqind, kurse dëmet e paguara nga kompanitë e sigurimeve shënuan rritje vjetore prej 9.1 përqind. Sektori i sigurimeve në vitin 2022 shënoi fitim në vlerë prej 3.5 milionë euro (6.3 milion euro një vit më parë).

Sipas raportit të BQK-së zvogëlimi i fitimit të realizuar kundrejt vitit të kaluar kryesisht reflekton rritjen e shpenzimeve operative, përkatësisht kostos së blerjes së mallrave dhe shërbimeve (ndikuar nga presionet inflacioniste në vitin 2022), shpenzimeve administrative (kryesisht kompensimit për punëtor) dhe dëmeve të ndodhura.

267.5 milionë €

ka qënë vlera e aseteve të sektorit të sigurimeve në fund të vitit 2022

11.2%

është rritur vlera e aseteve të sektorit të sigurimeve gjatë vitit 2022 në raportin më vitin paraprak.

134 milionë €

ka qënë vlera e primeve të shkruara bruto në fund të vitit që lamë pas.

14.1%

është rritur vlera e primeve të shkruara bruto gjatë vitit 2022 në raportin me vitin paraprak.

58,9%

të hyrave të sektorit të sigurimeve në vendin tonë gjatë vitit 2022 janë obligative.

ÇKA ËSHTË SISTEMI BONUS-MALUS

Sistemi Bonus-Malus është një sistem i cili rregullon nivelin e primit të sigurimit të automjetit, bazuar në historikun e dëmeve të të siguruarit (policëmbajtësit). Secilit të siguruar në Kosovë, që ka kontratën (policën) e sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia me afat të paktën një vit, niveli i primit i caktohet sipas shkallëve të sistemit Bonus-Malus. Të gjithë mbajtësit e polisave të cilët nuk kanë shkaktuar aksidente brenda një viti do të përfitojnë nga bonusi i cili do të zvogëloj shkallën

e primit të sigurimit të tyre për vitin e ardhshëm. Rëndësia e këtij sistemi është se nga Bonusi do të përfitojnë shoferët e mirë dhe të disiplinuar dhe ata që janë të kujdesshëm në trafik dhe në të njëjtën kohë nëpërmjet Malusit shoferët e papërgjegjshëm që shkaktajnë aksidente do të jenë në disavantazh.


Zbatimi i sistemit Bonus Malus bëhet në bazë të informacioneve të gjeneruara nga Qendra e Informative e Sigurimeve e cila menaxhohet nga Byroja Kosovare e Sigurimit(BKS), apo informa-

cioneve nga subjekte tjera të pranueshme për BQK-në. Siguruesit obligohen të aplikojnë këtë rregullore vetëm për rastet e lëshimeve të policave të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia për personat fizikë, ndërsa zbatimi i sistemit Bonus Malus për personat juridikë rregullohet nga vetë siguruesit ose Byroja Kosovare e Sigurimit. E drejta për një shkallë të caktuar të primit (bonus/malus) lidhet me të siguruarin, përkatësisht policëmbajtësin dhe nuk kalon te pronari i ri.

● Nëse kontrata e sigurimit ka skaduar dhe i siguruari nuk kontraktin policë të re njëvjeçare, pas kalimit të periudhës kohore më shumë se 15 ditë dhe më pak se 45 ditë, nga data e skadimit, atëherë ndaj të siguruarit aplikohet një shkallë më e lartë e primit, por jo më shumë se shkalla 11, krahasuar me shkallën e primit të aplikuar në kontratën e fundit të skaduar, me kusht që gjatë kësaj periudhe nuk është deklaruar dëm.

● Nëse kontrata e sigurimit ka skaduar dhe i siguruari nuk kontraktin policë të re njëvjeçare edhe pas kalimit të periudhës prej 45 ditëve deri në një vit nga data e skadimit, atëherë ndaj të siguruarit aplikohet primi dy shkallë më i lartë, por jo më shumë se shkalla bazë e primit (shkalla 11), krahasuar me shkallën e primit të aplikuar në kontratën e fundit të skaduar, me kusht që gjatë kësaj periudhe nuk është deklaruar dëm.

Bazuar në Ligjin për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto-përgjegjësia, BQK ka miratuar rregulloren për zbatimin e sistemit Bonus-Malus. Shkallët e primit në përqindje që nga shkalla themelore e primit 11 (100%) janë këto:



● Për çdo dëm të deklaruar në periudhën e vëzhgimit pavarësisht nga kohëzgjatja e sigurimit, të siguruarit për vitin pasardhës i aplikohet primi për tre (3) shkallë primi më lart, por jo më shumë se deri te shkalla e nëntëmbëdhjetë (19), ashtu siç përcaktohet me paragrafin 9 të këtij neni.

● Nëse kontrata e sigurimit ka skaduar dhe i siguruari nuk kontraktin policë të re njëvjeçare prej një vit e më shumë nga data e skadimit, atëherë i siguruari e humb të drejtën e përfitimit të shkallës më të ulët të primit, dhe rikthehet në shkallën bazë të primit (shkalla 11), me kusht që gjatë kësaj periudhe nuk ka dëm të raportuar.

DYSHIME PËR INSKENIM AKSIDENTESH, NJË PERSON I PËRFSHIRË NË 29 AKSIDENTE BRENDA DY VITEVE

Në 29 aksidente trafiku brenda dy viteve, është përfshirë një burrë rreth 40 vjeç nga Komuna e Prishtinës. Ai ka kërkuar kompensim në 9 kompani të sigurimeve. Kjo edhe ka bërë që të ngrihen dyshime për inskenim të aksidenteve në trafik, me qëllim të përfitimeve materiale. Nga Byroja Kosovare e Sigurimit thonë se shuma e paguar nga kompanitë e sigurimeve gjatë vitit të kaluar për personat që kanë pësuar lëndime të lehta trupore nga aksidentet në trafik kapin vlerën e mbi 12 milionë e 324 eurove, shkruan RTK. Por, cilët janë shembujt kur një person është përfshirë madje edhe në dhjetëra aksidente?

RASTI 1

Një person ka paraqitur 16 kërkesa në 7 kompani të sigurimeve për një periudhe 2-vjeçare, ku janë të përfshirë 6 persona.

RASTI 3

Një person ka paraqitur 20 kërkesa në 8 kompani të sigurimeve për një periudhe 1-vjeçare, ku janë të përfshirë 3 persona.

RASTI 5

Një person ka paraqitur 29 kërkesa në 9 kompani të sigurimeve për një periudhe 2-vjeçare, ku janë të përfshirë 5 persona.

RASTI 2

Një person ka paraqitur 18 kërkesa në 8 kompani të sigurimeve për një periudhe 5 vjeçare, ku janë të përfshirë 3 persona.

RASTI 4

Një person ka paraqitur 22 kërkesa në 9 kompani të sigurimeve për një periudhe 3-vjeçare, ku janë të përfshirë 6 persona.

RASTI 6

Një person ka paraqitur 19 kërkesa në 8 kompani të sigurimeve për një periudhe 2-vjeçare, ku janë të përfshirë 2 person

Policia e Kosovës nuk ka dhënë sqarime për rastet konkrete por ka treguar statistika të përgjithshme të aksidenteve.

Nga policia kanë thënë se gjatë tremujorit të parë janë raportuar 3 mijë e 114 persona të lënduar nga aksidentet në trafik, 127 më shumë se periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Qytetarët që kanë pësuar lëndime të lehta trupore janë referuar për kontrolle mjekësore në Qendrat e Mjekësisë Familjare.

“Në qendrën tonë ka raste mirëpo nuk janë raste të shpeshta që kërkojnë ndihmë për aksidente.

Kur ka lëndime të lehta trupore, trajtimin e marrin në qendrën tonë, mirëpo nëse kanë lëndime më të rënda thirrret urgjenca dhe bëhet transporti për në qendrën emergjente”, ka thënë Ilire Bunjaku, doktoreshë familjare në QKMF.

Nga Byroja e Sigurimeve të Kosovës kanë treguar se kompanitë e sigurimeve kanë paguar mbi 30 milionë e 544 mijë euro për dëmet e shkaktuara në aksidentet në trafik gjatë 2022-s.



DREJTORI MAZREKU PREZANTOI SKEMËN E MUNDSHME TË MASHTRIMIT TË SIGURIMEVE

Drejtori i Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS) së bashku me bashkëpunëtorë në një work shop me gazetarë që përcjellin sektorin e ekonomisë ka prezantuar skemën e mashtrimit që u bëhet kompanive të sigurimit nga persona të papërgjegjshëm. Drejtori Mazreku para gazetarëve ka ofruar dëshmi të shumta se si persona të papërgjegjshëm duke simuluar aksidente arrijnë të përfitojnë shuma të konsiderueshme të mjeteve, pothuajse nga të gjitha kompanitë e sigurimeve që operojnë në vendin tonë. “Dëmi që u shkaktohet kompanive nga këta persona të papërgjegjshëm nuk është i vogël. Ne kemi arritur të grumbullojmë të dhëna të shumta përmes sistemit tonë dhe të gjitha tashmë i kemi dorëzuar në hetuesi. Ne kemi identifikuar raste ku 1 person arrin të përfitojnë 29 herë thujse nga të gjitha kompanitë e



sigurimeve”, ka treguar drejtori Mazreku.

Ai më tutje para gazetarëve ka treguar se tashmë për here të dytë edhe raporti i audi-

torit të jashtëm për Byronë Kosovare të Sigurimit ka dalë pa asnjë kualifikim që është dëshmi e një menaxhimi të mirë.

BKS-JA KËTË VIT KA MBËSHTETUR PROJEKTIN “SIGURIA NË RRUGË”

Byroja Kosovare e Sigurimit këtë vit ka mbështetur projektin “Siguria në rrugë”, i zhvilluar nga kolegji Tempulli, por edhe Institucione tjera të rëndësishme. Në edicionin e sivjetmë, përgjatë muajit mars dhe prill janë vizituar mbi 40 shkolla të mesme në 25 komuna të Kosovës, përkatësisht mbi 300 paralele me maturantë. Kjo moshë është kategoria kryesore e ngasjes së biçikletave dhe trotinetëve elektrikë dhe shumica prej tyre janë në proces të aftësimit për kursin për drejtimin e mjeteve motorike. Nxënësit fitues nga mbarë vendi do të ftohen në Prishtinë në takimet tradicionale komunale në javën e tretë të muajit maj 2023, ku do të zhvillohen garat finale republikane biçikleta sikurse viteve tjera.

Me këto aktivitete tash e dhjetë vite përveç që kemi mbajtur gjallë vigjilencën e nxënësve për një siguri më të madhe në rrugë, kemi arritur të plotësojmë edhe boshllëkun dhe mungesën në kurrikulën kombëtare sa i përket temave/moduleve për edukatën dhe kulturën në trafik. Aktivitetet e zhvilluara këtë vit në kuadër të projektit kombëtar “Siguria në rrugë” kanë dhënë fryte për sa i përket edukimit dhe vetëdijesimit të nxënësve për sigurinë në rrugë. Përveç kësaj kanë ndihmuar edhe në identifikimin e njohurive të nxënësve në njohjen e rregullave dhe shenjave të trafikut, ku si rezultat i aktiviteteve në fjalë deri më tani janë realizuar:

- 40 vizita në shkolla të mesme të larta;
- Mbi 300 paralele të vizituara;



Mbi 5 paraqitje mediale për aktivitetin e sivjetme;

5000 teste në lidhje me njohuritë e maturantëve për shenjat e trafikut;

5000 pyetësorë;

1 sesion i ligjëratave online për njohuritë për shenjat dhe rregullat e trafikut.

Këto aktivitete të sivjetme janë kontribut konkret në planin e veprimit të përbashkët në rritjen e sigurisë në rrugë si kërkesë e Planit Global për Dekadën e Veprimit 2021-2030 të Organizatës së Kombeve të

Bashkuara.

Të pranishëm në realizimin e aktiviteteve të Edicionit të tetë të Rivistës shkollore “Siguria në rrugë-2023” ishin, profesor Muhamed Krasniqi nga Tempulli, Sami Mazreku nga Byroja Kosovare e Sigurimit, N/Kolonel Jeton Rexhepi, N/Kolonel Afrim Ahmeti dhe zyrtar tjerë nga Policia e Kosovës, drejtor Nezir Gashi nga DKKSKRR, përfaqësues nga MASHTI, Komuna e Prishtinës, AMRKS, studentët dhe stafi i Tempullit.

NDARJA E TREGUT NË SIGURIMET MOTORIKE

SIGURIME

Tregu i sigurimeve motorike vetëm gjatë tremujorit të parë të këtij viti sipas të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) ka arritur në 19,853,694 euro.

Duke iu referuar të dhënave zyrtare më tutje shihet se nga kjo shumë totale 15,315,896 euro janë të hyrat e kompanive

të sigurimit nga shitja e policave të brendshme TPL, derisa 858,093 euro janë të hyrat e kompanive të sigurimeve nga shitja e policave TPL +, gjatë periudhës janar-mars 2023. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe kohore tremujore, 1,065,238 euro janë të hyrat nga shitja e policave kufitare, derisa 2,321,174 euro janë të hyrat e kompanive të

sigurimit nga shitja e policave Kasko gjatë periudhës janar-mars 2023, si dhe në fund 293,292 euro janë të hyrat e kompanive të sigurimit nga shitja e policave për sigurim të transportit.

Nëse e bëjmë një krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak shihet se ka një rritje prej rreth 2,5 milionë euro.

15,315,896€

janë të hyrat e kompanive të sigurimit nga shitja e policave të brendshme TPL gjatë periudhës janar-mars 2023.

13,902,450€

janë të hyrat e kompanive të sigurimit nga shitja e policave të brendshme TPL gjatë periudhës janar-mars 2022.

858,093€

janë të hyrat e kompanive të sigurimeve nga shitja e policave TPL + gjatë periudhës janar-mars 2023.

709,088€

janë të hyrat e kompanive të sigurimit nga shitja e policave të brendshme TPL gjatë periudhës janar-mars 2022.

1,065,238€

janë të hyrat nga shitja e policave kufitare gjatë periudhës janar-mars 2023

1,010,545€

janë të hyrat nga shitja e policave kufitare gjatë periudhës janar-mars 2022.

2,321,174€

janë të hyrat e kompanive të sigurimit nga shitja e policave Kasko gjatë periudhës janar-mars 2023.

1,816,723€

janë të hyrat e kompanive të sigurimit nga shitja e policave Kasko gjatë periudhës janar-mars 2022.

293,292€

janë të hyrat e kompanive të sigurimit nga shitja e policave për sigurim të transportit gjatë tre mujorit të parë 2023.

68,832€

janë të hyrat e kompanive të sigurimit nga shitja e policave për sigurim të transportit gjatë tre mujorit të parë 2022.

19,853,694€

janë të hyrat totale nga sigurimet motorike gjatë tre mujorit të parë të vitit 2023.

17,507,639€

janë të hyrat totale nga sigurimet motorike gjatë tre mujorit të parë të vitit 2022.

DREJTORI I BKS-SË MIRËPRET AKSIONIN E POLICISË PËR HEQJEN NGA QARKULLIMI TË AUTOMJETEVE TË PAREGJISTRUARA

Drejtori i Byrosë Kosovare të Sigurimit, Sami Mazreku, ka mirëpritur aksionin e policisë së Kosovës për heqja nga qarkullimi të automjeteve pa regjistrim. Sipas tij, heqja e veturave të tilla nga qarkullimi ndikon direkt në rritjen e sigurisë në komunikacion. Përmes një komunikate për media policia ka njoftuar se në Rajonin e Prishtinës po vazhdon implementimi i planeve operative për ngritjen e sigurisë në trafik. Policia e Rajonit të Prishtinës, respektivisht Njësi Rajonal i Trafikut rrugor, në kuadër të aktivitete të planifikuara për qëllim të sigurisë rrugore, tani në veturën “inteligjente” kanë instaluar sistemin e identifikimit të veturave të pa regjistruara të cilat qarkullojnë në rrugë. Ky sistem kryen identifikimin automatik të menjëhershëm të veturave të paregjistruara edhe gjatë lëvizjes. Vetëm për dy ditë të veprimit, janë identifikuar 38 vetura të paregjistruara (disa prej



automjeteve kanë rezultuar pa regjistrim që nga viti 2012). Ndaj shoferëve janë shqiptuar fletëparaqitjet sipas ligjit si

dhe veturat janë përjashtuar nga trafiku duke i konfiskuar përkohësisht targat e regjistrimit.

ORGANIZOHEN GARAT ME BIÇIKLETA NË KUADËR TË EDICIONIT “SIGURIA NË RRUGË 2023”

Garat u mbajtën në sheshin “Xhorxh Bush” në Prishtinë, ku pjesëmarrës ishin matorantë të shumë shkollave në Kosovë si përfaqësues të shkollave të tyre.

Drejtori i Akademisë “Tempulli”, Muhamed Krasniqi, tha se këtë vit bëhet një dekadë prej kur kanë nisur këto aktivitete për sigurinë në rrugë. Si të tilla, ai ka shtuar se tashmë kanë marrë karakter edukativ dhe arsimor. Pjesëmarrës në këto aktivitete për 10 vjet kanë qenë më shumë se 10 mijë nxënës.

“Është edicioni i tetë me radhë. Sot do të garojnë matorantët nga shkollat përfaqësues të Republikës së Kosovës, për të fituar njërin nga shpërblimet që janë, biçikleta për vendin e parë, dytë dhe të tretë”, ka thënë Krasniqi.

Nënkryetarja e Prishtinës, Donjeta Sahatçiu, ka theksuar se janë duke punuar për zgjerimin e shtigjeve për biçikletat dhe do të vazhdojnë të promovojnë sigurinë dhe lëvizjet me biçikleta në kryeqytet. Ajo shtoi se komuna vazhdon të jetë e zotuar të punojë për sigurinë dhe sigurimin e shtigjeve për biçikleta.

Nënkoloneli i Policisë së Kosovës, Jeton Rexhepi, theksoi se mbështesin çdo aktivitet,



itet, me qëllim të uljes së rasteve të aksidenteve në rrugë.

Në garat e sotshme pjesëmarrës ishin 19 garues në 12 shtigje, ku vendi i parë, dytë dhe i tretë u shpërblen me nga një biçikletë, dhe shkolla e fituesve u pajis me një kupë.

• Fituesi i vendit të parë u shpall Darsei Gashi, përfaqësues i shkollës së mesme

teknike Skënder Luarasi nga Suhareka, i cili shtegun e kaloi pa asnjë penallti, brenda 40 sekondash.

• Fituesi i vendit të dytë u shpall Enris Xhelili nga shkolla e mesme teknike Mehmet Isai nga Gjilani, i cili shtegun e kaloi me sukses dhe pa asnjë penallti, për 46 sekonda.

Gati janë barazuar sigurimet vullnetare me ato obligative

Gjatë tremujorit të parë të këtij viti gati janë barazuar sigurimet vullnetare me ato obligative. Sipas të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) shihet se gjatë tremujorit të parë të këtij viti shuma e primeve obligative ka arritur në 17,2 milionë euro, derisa atyre e atyre vullnetare 15,1 milionë euro.

Sigurimet vullnetare në vendin tonë vazhdojnë të rriten nga dita në ditë, gati duke u barazuar me sigurimet obligative siç janë TPL, TPL + si dhe policat kufitare. Gjatë tremujorit të parë të këtij viti gati janë barazuar sigurimet vullnetare me ato obligative. Sipas të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) shihet se gjatë tremujorit të parë të këtij viti shuma e primeve obligative ka arritur në 17,2 milionë euro, derisa atyre vullnetare 15,1 milionë euro. Përfaqësues të Industrisë së sigurimeve në vendin tonë thonë se rritja numrit të sig-

urimeve është rritje e vetëdijes së qytetareve. Nëse i krahasojmë të dhënat e tremujorit të parë të këtij viti me të dhënat e tremujorit të parë të vitit 2022, sa u përket sigurimeve vullnetare, shihet se ka ndryshim të dukshëm prej më shumë se 3 milionë euro. Por, sipas tyre trendi i rritjes do të vazhdojë edhe në muajt në vijim pasi qytetarët e kanë kuptuar rëndësinë e sigurimit shëndetësor. Gjithnjë nëse u referohemi të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës shihet se 17,239,228 është shuma e primeve të inkuaruar gjatë tremujorit

të parë të vitit 2023, në emër të sigurimeve obligative, derisa 15,622,083 është shuma e primeve të inkuaruar gjatë tremujorit të parë të vitit 2022, në emër të sigurimeve obligative. Ndërkaq sa i përket sigurimeve vullnetare shihet se 15,148,364 është shuma e primeve të inkuaruar gjatë tre muajorit të parë të vitit 2023 në emër të sigurimeve vullnetare, derisa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak 12,258,640 ishte shuma e primeve të inkuaruar gjatë tremujorit të parë të vitit 2022 në emër të sigurimeve vullnetare.

2022

2023

Shuma e primeve të inkuaruar gjatë tremujorit të parë, në emër të sigurimeve obligative.

15,622,083€

17,239,228€

Shuma e primeve të inkuaruar gjatë tremujorit të parë, në emër të sigurimeve vullnetare.

12,258,640€

15,148,364€

Shuma e primeve të inkuaruar gjatë tremujorit të parë, në emër të sigurimeve vullnetare dhe atyre obligative.

27,880,723€

32,387,592€



DREJTORI BKS-SË E MBAJTI PREZANTIMIN PRA STUDENTEVE TË UNIVERSITETIT TË PEJËS

Drejtori i Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS) z.Sami Mazreku, së bashku me Valon Berishën dhe Ilir Prapashticën, të mërkurën kanë vazhduar mbajtjen e prezantimit para studenteve të Universitetit Haxhi Zeka në Pejë. Drejtori Mazreku si dhe Prapashtica e Berisha

para studenteve të këtij universiteti kanë folur rreth funksionimit të sektorit të sigurimeve në vendin tonë, si dhe më detajisht punën që bën Byroja Kosovare e Sigurimit. Takime dhe prezantime nëpër institucione edukative BKS-ja ka nisur nga fillimi i viti e do të vazhdojë deri në përfundim të

këtij viti. Në fund të takimit drejtori BKS-së së bashku me bashkëpunëtorë ka takuar edhe dekanin e Fakultetit të Biznesit në Pejë z.Halit Shabani, me të cilin kanë biseduar rreth mundësisë së rritjes së bashkëpunimit në mes të këtyre dy institucioneve të rëndësishme.

15,315,896€

është shuma e mjeteve që kompanitë e sigurimeve kanë inkasuar nga shitja e policave TPL e brendshme gjatë periudhës janar-mars 2023.

13,902,450€

është shuma e mjeteve që kompanitë e sigurimeve kanë inkasuar nga shitja e policave TPL e brendshme gjatë periudhës janar-mars 2022.

10,17 %

janë rritur të hyrat e kompanive të sigurimeve nga shitja e policave TPL e brendshme gjatë periudhës janar-mars 2023 në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

7,376,374€

është shuma e dëmeve të paguara nga kompanitë e sigurimeve për demet e shkaktuara vetëm në aksidente komunikacioni gjatë periudhës janar-mars 2023.

6,340,904€

është shuma e dëmeve të paguara nga kompanitë e sigurimeve për demet e shkaktuara vetëm në aksidente komunikacioni gjatë periudhës janar-mars 2022.

16,33 %

është më e lartë shuma e dëmeve që kompanitë e sigurimeve kanë paguar gjatë periudhës janar-mars 2023 për demet e shkaktuar në aksidente komunikacioni në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

23,24 % rritet shitja e policave kufitare

Gjatë muajve janar, shkurt dhe mars të këtij shitja e policave kufitare është rritur për 23,24 % në raport me muajin janar të vitit

që lamë pas. Duke iu referuar të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës shihet se gjatë muajit janar dhe shkurt

të këtij viti janë shitur 51,953 polica kufitare, nga 26,999 polica kufitare janë shitur gjatë muajve janar dhe shkurt 2022.

51,953

polica kufitare janë shitur gjatë muajve janar, shkurt dhe mars 2023.

42,085

polica kufitare janë shitur gjatë muajve janar, shkurt dhe mars 2022.

23,24%

është rritur shitja e policave kufitare gjatë muajve janar-mars 2023 në raport me muajt janar-mars 2022.

2072 polica për sigurim nga zjarri

Vetëm gjatë muajve janar, shkurt dhe mars këtij viti kompanitë e sigurimeve në vend kanë shitur 2072 polica sigurim nga zjarri, nga 1927 polica

sigurim nga zjarri sa janë shitur gjatë muajve janar-mars 2022. Duke iu referuar të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës shihet se gjatë

muajve janar-mars të këtij viti shitja policave është më e lartë për 7,52 % në raport me periudhën e njëjte të vitit paraprak.

2,072

polica sigurimi nga zjarri janë shitur gjatë muajve janar-mars 2023.

1,926

polica sigurimi nga zjarri janë shitur gjatë muajve janar-mars 2022.

7.52%

është rritur shitja e policave të sigurimit nga zjarri gjatë muajve janar-mars 2023 në raport me muajt janar-mars 2022.

3990 polica për sigurim të mjeteve tokësore

Gjithnjë duke iu referuar të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës shihet se gjatë periudhës janar –mars të këtij viti kompanitë e sigurimeve në vend kanë

shitur 3990 polica për sigurim të mjeteve tokësore, ndërsa 3517 polica për sigurim të mjeteve tokësore janë shitur gjatë muajve janar-mars 2022. Nëse bëjmë një krahasim

të thjeshtë shihet se 14,45 % është rritur shitja e policave për sigurimin e mjeteve tokësore gjatë muajve janar-mars 2023 në raport me muajin janar-mars 2022.

3,990

polica për sigurim të mjeteve tokësore janë shitur gjatë muajve janar-mars 2023.

3,517

polica për sigurim të mjeteve tokësore janë shitur gjatë muajve janar-mars 2022.

14.45%

është rritur shitja e policave për sigurimin e mjeteve tokësore gjatë muajve janar-mars 2023 në raport me muajt janar-mars 2022.



BQK-JA PËRKRAH BKS-NË NË PROCESIN E REFORMIMIT

Nexhat Kryeziu, u.d i zëvendësguvernatorit të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), ka vizituar të martën Byronë Kosovare të Sigurimit (BKS), ku është takuar me drejtorin z.Sami Mazreku si dhe z.Agim Elshani, kryesues i Asamblesë së Përgjithshme dhe z.Korab Lluka, kryetar i Këshillit Administrativ në Byronë Kosovare të Sigurimit. Drejtori Mazreku ka falënderuar Kryeziun që vizitën po e

bën në Institucionin që ai drejton. Mazreku e ka njoftuar zëvendësguvernatorin me reformat, ndryshimet dhe sukseset që kanë pasur në këtë Institucion gjatë dy viteve të fundit. Gjithashtu Mazreku ka kërkuar mbështetje të mëtutjeshme të BQK-së për të vazhduar reformat dhe ndryshimet ligjore që duhet t'i përshtatën kohës. Në anën tjetër zëvendësguvernatori Kryeziu ka uruar menaxhmentin e BKS-së

për angazhimin e madhe që ka pasur në ndryshimin në tersi të Byrosë Kosovare të Sigurimit. Gjithashtu zëvendësguvernatori i ka ofruar mbështetje të mëtutjeshme BKS-së në proceset që kanë për qëllim reformimin e këtij institucioni të rëndësishëm. Po ashtu, gjatë takimit është diskutuar edhe për gjetjen e modaliteteve në anëtarësimin e Kosovës në Byronë e Kartonit të Gjelbër.

PREZANTIM PARA NXËNËSEVE TË SHKOLLËS HASA PRISHTINA NË MITROVICË

Drejtori i Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS) z.Sami Mazreku së bashku me Valon Berishën dhe Ilir Prapashticën kanë mbajtur një prezantim para nxënësve të shkollës së mesme "Hasan Prishtina" në Mitrovicë.

Drejtori Mazreku si dhe Prapashtica e Berisha para tyre kanë shpjeguar rëndësinë e sigurimeve, por edhe informacione të shumta që në të ardhmen do të jenë shumë të nevojshme për ta.

Takime dhe prezantime nëpër institucione edukative BKS-ja ka nisur nga fillimi i viti e do të vazhdojë deri në përfundim të këtij viti. Në fund të takimit drejtori BKS-së i ka ftuar nxënësit që të vizitojnë edhe Institucionin që ai drejton për të parë nga afër se si funksionon.



SIGURIMET NË NUMRA

34,208,630€

ka arritur volumi i primeve të shkruara bruto, në fund të muajit mars të këtij viti.

5,814

dëme më shumë janë paguar gjatë muajve janar-mars 2023, sesa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

14.92%

është rritur tregu i sigurimeve gjatë muajve janar-mars 2023, në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

4,442,171€

është rritur volumi i primeve të shkruara bruto gjatë muajve janar-mars 2023, në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

322,868

ka arritur numri i kontratave të kompanive të sigurimit me qytetarët në fund të muajit mars të këtij vitit 2023.

36.66%

është rritur numri i kontratave të kompanive të sigurimit me qytetarët në fund të muajit mars 2023, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

48,165

dëme janë paguar nga kompanitë e sigurimeve, por edhe nga Byroja Kosovare e Sigurimeve, vetëm gjatë muajit mars 2023.

32,387,592 €

ka arritur volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jo-Jetës, deri në fund të muajit mars 2023.

16,16%

është rritur volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jo-Jetës, deri në fund të muajit mars të vitit 2023.

1,821,041€

ka arritur volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jetës, deri në fund të muajit mars 2023.

3,43%

ka rënë volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jetës deri në fund të muajit mars të këtij viti, në raport me periudhën e njëjte të vitit paraprak.

25,245

ka arritur numri i kontratave në sigurimin e jetës, në fund të muajit mars 2023.

174%%

është rritur numri i kontratave në sigurimin e jetës gjatë muajit mars 2023, në raport me muajin mars 2022.

Performanca e sektorit të sigurimeve gjatë periudhës janar-mars 2023, në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.